



Nr. Ref. BD-170/1

Në bazë të neneve 15.2.1, 15.2.12 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 (të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 06/L-023, Ligjin nr. 05/L-080 dhe Ligjin 04/L-115), nenin 18.1.4 të Shtojcës së po të njëjtit Ligj, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur me datën me 17 tetor 2022 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Aprovohet Rregullorja nr. 06/2022 për shitjen direkte të aseteve të caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.**
- II. **Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.**


ARSYETIM

Pas shqyrtimit të propozimit nga Menaxhmenti dhe propozimeve nga anëtarët e Bordit, Bordi aprovoi sipas procedurave Rregulloren për shitjen direkte të aseteve të caktuara të Ndërmarrjeve Shoqërore.

Ky vendim është marr duke marr parasysh faktin se Rregullorja ka për qëllim të parashihen dhe kodifikohen dispozitat e nevojshme për identifikimin dhe shqyrtimin e aseteve me karakter specifik në pronësi të ndërmarrjeve shoqërore, inicimin e procedurës lidhur me aplikimin e shitjes direkte si zgjidhje juridike alternative në pajtim me nenin 15, lidhur me nenin 18, paragrafi 1.4 të Shtojcës së Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit që parasheh negociatat direkte për shitjen e aseteve sipas rregullores së miratuar nga Bordi i Drejtorëve.

Ndryshimet që janë bërë në këtë rregullore nga ajo aktuale janë se versioni i ri i Rregullores adreson fillimisht të gjeturat e auditorit të brendshëm për aq sa ka qenë e mundur dhe e lejuar të adresohen bazuar, si dhe sfidat e procesit të negocimit me të cilat Agjencia është përballur përgjatë punës së sajë. Duke marr parasysh të gjitha më lartë Bordi shqyrtoi propozimin sipas materialit të paraqitur në këtë pikë dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Prishtinë, më 17 Tetor 2022.



Syzana Dautaj Surdulli
Zëvendës Kryesuese
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit

